

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANATI

Nr. 307/prot.

Tiranë, më 13.05.2019

**Lënda:** *Mbi plotësimin e orëve mësimore për semestrin e dytë si rezultat i shtyrjes së fillimit të procesit mësimor një javë më vonë.*

**V E N D I M**

- Duke u bazuar në faktin se në Fakultetin e Artit Skenik gjatë periudhës së fund vitit 2018 dhe fillimit të vitit 2019, se rezultat i bojkotit të mësimit nga studentët, nuk ka patur një zhvillim normal të procesit mësimor,
- Duke vlerësuar se në strukturën e miratuar nga Rektori i UART semestri i dytë duhej të fillonte në datë 04.03.2019 por me vendim të dekanatit nr.100 prot. datë 28.01.2019 si rezultat i bojkotit është shtyrë 1(një) javë dhe ka filluar në datë 11.03.2019,
- Duke vlerësuar faktin se semestri i dytë bazuar në strukturën e miratuar nga Rektori i UART përfundon në datë 14.06.2019,

Dekanati i Fakultetit të Artit Skenik, i mbledhur sot më datë 13.05.2019

*vendosi:*

1. Të plotësohet një javë e procesit mësimor për semestrin e dytë ( 5 ditë mësimore nga e hëna në të premte) ditët e shtuna si më poshtë:
  - **Datë 18.05.2019** të zhvillohet mësimi i ditës së hënë
  - **Datë 25.05.2019** të zhvillohet mësimi i ditës së martë
  - **Datë 01.06.2019** të zhvillohet mësimi i ditës së mërkurë
  - **Datë 08.06.2019** të zhvillohet mësimi i ditës së enjte
  - **Datë 15.06.2019** të zhvillohet mësimi i ditës së premte
2. Gjithçka që paqyrohet në këtë vendim të reflektohet në dokumentin zyrtar, konkretisht rregjistrin mësimor.
3. Sezoni i provimeve të semestrit të dytë i përcaktuar në strukturën vjetore të vitit akademik 2018-2019 nuk ndryshon.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Përgjegjësit e Departamenteve dhe pedagogët në Fakultetin e Artit Skenik, Zv/Dekani si dhe Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Artit Skenik.
5. Me këtë vendim të njoftohen studentët dhe pedagogët e FAS , administratori i FAS si dhe Rektorati i Universitetit të Arteve.
6. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

**Përgjegjësi i Njesisë Bazë Skenografi –Koreografi,**

**Përgjegjësi i Njesisë Bazë Aktrim –Teori Arti,**

**Përgjegjësi i Njesisë Bazë Regji – Regji Filmi & TV,**

**Zv/Dekani i FAS**

**Prof. Ilir MARTINI**

**Prof.Asoc.Dr.Elida RAPTI**

**Prof. Miltiadh Kutali**

**Prof. Gazmend Gjoka**

**DEKANI**

**Prof. Petrit MALAJ**

**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**